RECENSION:

Roberto Cipriani

Professor Emeritus
Roma Tre University

ALI PAJAZITI, *SOCIOLOGICAL TRILOGY: IDENTITY, RELIGION, ETHICS*, LOGOS-A & SHOQATA E SOCIOLOGËVE TË MAQEDONISË, Shkup, 2026, 378 fq.



Në këtë libër, *"Trilogjia Sociologjike: Identiteti, Religjioni, Etika"*, profesori Ali Pajaziti, përmes disa vrojtimeve të fokusuara, arrin të përcjellë një pasqyrim jashtëzakonisht të qartë dhe të detajuar të dinamikave socio-kulturore bashkëkohore në Maqedoninë e Veriut. Autori portretizon të gjitha divergjencat e saj, përkatësitë e ndryshme kulturore si dhe dallimet në qëndrime e sjellje, të cilat burojnë nga identitetet e tyre themelore — historike, kulturore, religjioze, vlerore, tradicionale dhe zakonore në kuptimin më të gjerë.

Një tjetër cilësi e rëndësishme e kësaj vepre është distanca e duhur që autori mban ndaj fenomeneve të trajtuara, duke respektuar me konsekuencë perspektivën veberiane të *Wertfreiheit* — domethënë lirinë nga gjykimet vlerësuese dhe idenë e neutralitetit vleror (*avalutativity*), e cila është e domosdoshme në shkencë. Pajaziti di mjaft mirë se si të lëvizë në këtë terren delikat, të mbushur me vështirësi, kurthe dhe të prirur ndaj keqkuptimeve.

Maqedonia e Veriut, e pavarur nga Jugosllavia që nga viti 1991, ka kaluar nëpër ngjarje të ndryshme dhe të stuhishme, veçanërisht në planin e emrit të shtetit me Greqinë fqinje, e cila po ashtu ka një rajon të quajtur Maqedoni me Selanikun si kryeqendër. Prej kohësh, vendi ndodhet në një tranzicion nga sistemi i vjetër federativ jugosllav drejt një qeverisjeje pro-demokratike të shtetit, duke u përballur me sfida historike në menaxhimin e interkulturalizmit, nacionalizmit, identiteteve gjuhësore-kulturore dhe marrëdhënieve ndërfetare. Prandaj, nëntitulli i kësaj përmbledhjeje esesh — *"Identiteti, Religjioni, Etika"* — duket i qëlluar maksimalisht.

Për më tepër, nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 13 gusht 2001 përcaktoi qartë problemet kryesore, duke filluar nga nevoja për t'i dhënë fund çdo forme të konfliktit, siç qëndron në mënyrë eksplicite në pikën 1.1 të parimeve themelore: "Përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike hidhet poshtë plotësisht dhe pa kushte". Trashëgimia e së kaluarës është shumë e rëndë për t'u përsëritur pasojat e saj. Përkundrazi, qëllimi është ndryshe: "Karakteri shumëetnik i shoqërisë së RMV-së duhet të ruhet dhe të pasqyrohet në jetën publike".

Vetë Marrëveshja vendos në plan të parë dy realitetet dominuese: maqedonasit dhe shqiptarët, por edhe komunitetet e turqve, vllehëve, romëve dhe të tjerëve. Bëhet fjalë për një mozaik jashtëzakonisht kompleks i cili reflektohet në kontributet e Ali Pajazitit ndaj refleksivitetit tonë. E njëjta gjë vlen edhe për praninë e shumëfishtë qeveritare dhe shoqërore të religjioneve, siç janë Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike dhe entitetet e tjera fetare minoritare. Për të gjithë ata është siguruar liria e besimit, së bashku me të drejtat e tjera tipike të komuniteteve fetare (shkollat, aktivitetet humanitare, etj.).

Por ky nuk është zgjedhja e vetme e temave që ngre autori. Në kontekstin social të Maqedonisë së Veriut veçohen edhe urgjenca të tjera: përhapja e mentalitetit konsumator, trendi i individualizmit, etnizimi i aktiviteteve ekonomike që kontribuojnë në statusin e një "shteti të papjekur" ose "proto-demokracie", abuzimet në privatizim, papunësia e lartë, varfëria e përhapur (e cila prek më shumë se një të tretën e popullisë) dhe tensionet etnike.

Në këtë skenar jashtëzakonisht problematik, autori lëviz me kujdes, duke përshkruar çdo fenomen deri në detajin më të imët, me qëllim që lexuesi të kuptojë fenomenet e ndërlikuara, komplikimet dhe antagonizmat që përshkojnë hapësirën dhe popullatën. Mbi të gjitha, imponohet konkluzioni se çështja kyçe është efektiviteti (ose joefektiviteti) i udhëheqjes (lidershipit) që menaxhon punët publike. Ky aspekt lidhet drejtpërdrejt me faktorin moral, korrupsionin dhe kapacitetin për qeverisje të mirë.

Më tej, vërehen ndërgrupime të shumta me faktorin religjioz, i cili ndikon si mbi liderët politikë, ashtu edhe mbi përkatësinë kombëtare-kulturore të qytetarëve. Këtu shohim tendencën e fuqishme për barazimin e religjionit me përkatësinë etnike. Në këtë kontekst, natyrshëm shfaqen edhe manifestime të tolerancës së ulët që çojnë në konfrontime rreth mënyrës se si jetohet spiritualiteti. Madje edhe pandemia e COVID-19 krijoi, ose të paktën nxiti situata të reja, me të ashtuquajturin "kthim të së shenjtës" (të vëzhguar përmes prizmit të intelektualëve shqiptarë).

Teksa analizon çështje të ndryshme, autori vë në qendër të vëmendjes identitetin dhe gjithë çfarë ai ngërthen. Ky koncept është shtylla kurrizore e të gjithë diskursit dhe ndihet qartë në çdo ligjërim e interpretim të Pajazitit. Dimensioni religjioz ka peshën e vet, por duket se varet ose të paktën dialogon vazhdimisht me perspektivën identitare.

Autori vë në dukje edhe specifikat e botës globale përmes analizës së shqiptarëve të Austrisë, të ndarë midis integrimit dhe mbrojtjes së kulturës së tyre specifike. Nga ana tjetër, ai prezanton edhe idenë e "Rrugës ballkanike të mëndafshit" (në vend të asaj kineze) midis Shkupit dhe Stambollit, duke potencuar lidhjen jetëgjatë mes Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë. Plotësisht elaborohet edhe çështja ekonomike e tregtisë që praktikohet kryesisht në korniza intra-etnike, gjegjësisht kufizimi i shkëmbimit dhe tregut pothuajse ekskluzivisht midis pjesëtarëve të të njëjtit komunitet kombëtar-kulturor.

Në fund, por jo më pak e rëndësishme, është e pranishme një iniciativë e shprehur për hapjen e sociologjisë ballkanike ndaj Evropës — një proces që zgjat prej kohësh dhe që ka marrë mbështetjen e Asociacionit Sociologjik Evropian (ESA) dhe Këshillit Evropian të Asociacioneve Sociologjike Kombëtare, të cilët angazhohen për një bashkëpunim gjithëpërfshirës.